



---

**VENDIM**  
**Nr.50 Datë 05.07.2010**

**PËR**  
**NDRYSHIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “SAROLLI” SH.P.K ME SERI PV03P,**  
**NR.07, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË**  
**KOMISIONEREVE TË ERE-S NR.15, DT.27.08.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikes 2.3 te licenses perprodhimin e energjise elektrike” neneve 10 dhe 15 pika 4 gërmat “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 05.07.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “SAROLLI” sh.p.k për ndryshimin e licensës Nr.07, Seria PV03P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.15 datë 27.08.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”,

**Vendosi:**

1. Ndryshimin e liçensës me Seri PV03P, Nr.07, lëshuar me Vendim te Bordit te Komisionereve te ERE-s nr.15, dt.27.08.2003, te mbajtur nga shoqeria “SAROLLI” sh.p.k.
2. Fuqia e instalaur e HEC Shpelle behet 400 kW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**